



Gratë në
negociata

RAPORT

GRATË NË TRYEZËN NEGOCIATAVE NË KOSOVË



Projekt i financuar nga
PSBE-ja



NEW SOCIAL
INITIATIVE

I zbatuar nga
New Social Initiative - NSI

Raport:

Gratë në tryezën e negociatave në Kosovë

Botues:

New Social Initiative - NSI

Redaktore:

Jovana Radosavljević

Autore:

Milica Radovanović

Përkthyes:

Bruno Nerizaj

Dizajni dhe radhitja:

Miloš Milovanović

Shtypi:

Pixel

Prishtinë,
Gusht 2021

Përgjegjësia e vetme e këtij botimi i takon autorit. Bashkimi Evropian nuk është përgjegjës për asnjë përdorim që mund t'u bëhet informatave të përfshira në të. Publikimi mund të citohet. Kërkesat për përdorim të pjesëve më të mëdha të tekstit duhet t'i drejtohen New Social Initiative.

E drejta e autorit © New Social Initiative

Raport Përmbajtja

Parathënie	6
Agjenda për gratë, paqen dhe sigurinë - RKSKB 1325	9
Plani i Veprimit i BE-së për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) 2019-2024	10
Gratë në proceset e negociatave	11
Korniza ligjore e Kosovës për përfshirjen e grave në vendimmarrje dhe negociata	13
Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës (PKV) për zbatimin e RKSKB 1325 dhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024	14
Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për barazinë gjinore	15
Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit	15
Gratë në pozita vendimmarrëse në Kosovë	17
Gratë në tryezën e negociatave në Kosovë	19
Konferenca e Rambujesë për Kosovën	20
Negociatat e Vjenës për statusin përfundimtar të Kosovës	21
Negociatat e Brukselit	22
Rreth Projektit përfshirja e grave në tryezën e negociatave në Kosovë	28
AKTIVITETI Nr.1 Lansimi i projektit nga Ambasadori SZUNYOG, EUSR në Kosovë dhe Fillimi i projektit	29
AKTIVITETI Nr.2 Sesion trajnimi mbi Agjendën e BE-së për Barazinë Gjinore	30
AKTIVITETI Nr.3 Sesion diskutimi për rolin e gruas në negociatat ndërkombëtare në Kosovë	31
AKTIVITETI Nr.4 Gjashtë tryeza të rrumbullakëta në gjashtë regjione të Kosovës me temën "Gratë dhe lidhshipi në nivel komunal"	33
Gjetjet e sondazhit dhe të tryezave të rrumbullakëta	35
Rekomandimet	42

Parathënie

Ambasador, Tomáš Szunyog
PSBE/Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë



Të nderuar lexues,

Në shtator u bë një vit që kur e mora pozitën e dyfishtë: atë të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian dhe të Shefit të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky ka qenë një vit sfidues, por edhe pasurues. Ajo që më bëri përshtypje më së shumti ishte energjia mbresëlënëse e popullit të Kosovës dhe shpirti i tyre sipërmarrës që mund të shihej kudo, përkundër sfidave të pandemisë Covid-19. Kam pasur rastin dhe kënaqësinë të takohem dhe të bisedoj me shumë gra të afta, profesionale, të mirinformuara në mbarë Kosovën. Puna e tyre e zellshme, pasioni për punën që bëjnë dhe guximi duhet të vihen re dhe të vlerësohen shumë. Ato janë forca shtytëse për ndryshime të mira, qoftë në familjet e tyre, në komunitetet lokale apo në tërë shoqërinë. Ato janë era e një ndryshimi pozitiv për Kosovën, Ballkanin Perëndimor, Evropën dhe gjithë botën. Ne kemi nevojë për më shumë gra udhëheqëse. Ne duhet të dalim nga kutia kufizuese e stereotipave me bazë gjinore dhe t'u japim zë dhe zgjedhje vajzave dhe grave në çdo fazë të jetës së tyre.

Barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut janë në zemrën e vlerave evropiane. Plani i Veprimit III për Barazinë Gjinore për vitet 2019-2024 synon t'i kontribuojë fuqizimit të grave, vajzave dhe të rinjve. Ata duhet t'i përdorin plotësisht të drejtat e tyre dhe ta rrisin pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Pikërisht kjo ide qëndron pas zbatimit të projektit të PSBE-së "Përfshirja e grave në tryezën e negociatave". Gjatë tërë gushtit, gra nga prejardhje, komunitete dhe rajone të ndryshme gjeografike u mbledhën në Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Graçanicë, Mitrovicë të Veriut dhe Prishtinë për të diskutuar për rolin e grave në udhëheqje, me fokus në rolin e tyre në ndërtimin e paqes dhe në negociata.

Josep Borrell, Përfaqësues i Lartë i BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, tha: "Sigurimi i të drejtave të njëjta për të gjithë i fuqizon shoqëritë tona. I bën ata më të pasur dhe më të sigurt. Ky është një fakt që shkon përtej parimeve apo detyrave morale. Pjesëmarrja dhe udhëheqja e grave dhe vajzave janë thelbësore për demokracinë, drejtësinë, paqen, sigurinë, prosperitetin dhe një planet më të gjelbër". E njëjta porosi u dëgjua edhe në konferencën në Prishtinë, të organizuar nga PSBE-ja në bashkëpunim me Iniciativën e Re Sociale dhe Asociacionin United Women [Gratë e Bashkuara]. Znj. Karin Hernmarck Ahliny, Ambasadore e Suedisë në Kosovë, dhe Znj. Barrie Lynne Freeman, Zëvendëse e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i ndanë përvojat e tyre të punës në diplomaci dhe pozita të larta. Përveç kësaj, a ka mënyrë më të mirë për të mësuar sesa nga dora e parë? Jo më pak interesante ishin edhe dëshmitë e grave në akademi, të prezantuara nga Linda Gusia, shefe e Departamentit të Sociologjisë në Universitetin e Prishtinës, Nita Luci, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, dhe Jehona Lushaku Sadriu, profesoreshë në Universitetin e Prishtinës. Ishte mirë të dëgjoje se gratë do ta mbështesin njëra-tjetrën dhe do të shkojnë dorë për dorë për ta arritur qëllimin e tyre përfundimtar: një botë më të mirë për të jetuar.

Jam i bindur që gratë e Kosovës kanë potencial të madh. Edhe pse legjislacioni është ende duke u përmirësuar, është bërë shumë punë. Mirëpo, duhet të ketë zbatim të duhur të ligjit dhe ekzekutim të fortë. Duhet të ketë pëlqim shoqëror dhe mirëkuptim të thellë që gratë mund të ndihmojnë. Barazia gjinore është vendimtare për trajtimin e sfidave globale dhe arritjen e qëllimeve si paqja, siguria, demokracia. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se të drejtat e grave janë nën presion të madh në tërë botën. Pandemia e ka treguar këtë në mënyrë shumë të qartë.

Në fund të parathënies sime, dëshiroj ta shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë ata që marrin pjesë dhe kontribuojnë në projektin e PSBE-së "Përfshirja e grave në tryezën e negociatave" dhe për prodhimin e kësaj broshure të shkurtër. Me të vërtetë shpresoj që kjo broshurë, kushdo që do ta mbajë në duar dhe ta lexojë atë – do të kontribuojë që të kuptohet më mirë roli i grave në komunitetin lokal dhe në botë.

**Karin Harnmack, Ambasadore e Suedisë në Kosovë
(Konferenca Gratë në tryezën e negociatave, Prishtinë)**

Në kohë të krizës, të drejtat e grave janë të parat që do të sulmohen.

Në situata stresuese, të drejtat që gratë i kanë sot duhet të mbrohen.

Sikur të gjitha të ishim nëna arusha që i mbrojmë këlyshët tanë, sepse do të kishte forca që do të donin të na i merrnin.

Duhet të kuptojmë që sukseset që i kemi arritur nuk janë automatike dhe nuk kanë ardhur natyrshëm. Ato thjeshtë nuk na janë dhënë. Ato janë rezultat i punës së palodhshme dhe i shumë ngjarjeve pasuese që çuan në të.

Numri i ulëseve në tryezat e negociatave dhe vendimmarrëse është i kufizuar. Ju mund t'i zgjeroni ato, por vetëm aq. Në fund të ditës, do të ketë një numër të kufizuar të vendimmarrësve që do ta mbajnë fatin e shumicës në duart e tyre. Futja e grave kërkon që dikush tjetër të largohet. Princave dhe aspirantëve të ndryshëm të kurorëzuar që e kanë përgatitur karrierën e tyre për të hyrë në atë pozitë të lartë, papritmas u kërkohet të largohen.

Pse do t'ju lejonin të uleni në tryezë dhe ta thoni mendimin tuaj se si të zgjidhni diçka përveç nëse atyre u kushton më shumë për t'ju mbajtur jashtë? Ju duhet t'u tregoni atyre se jeni të interesuara dhe se është me rëndësi të jeni atje për ta marrë rezultatin më të mirë të mundshëm.

Për t'u përfshirë, kostoja e përjashtimit duhet të jetë mjaft e lartë - atyre duhet t'u kushtojë më shumë për të mos ju përfshirë sesa për t'ju lënë jashtë.



**Barrie Lynne Freeman,
Zëvendëse e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (ZPSSP)
Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)**

Arritjet e grave nuk janë të sigurta askund, por ka pasur arritje të mëdha gjatë viteve, dhe nëse i shikoni ato në të kaluarën, tani kemi shumë më shumë gra të shkolluara në botë, shumë më shumë gra në qeveri dhe biznes.

Në shoqëritë ku gratë nuk kanë të drejta ose nuk kanë mundësi t'i ushtrojnë të drejtat e tyre, edhe nëse kanë të drejta në letër, ne duhet të bashkohemi dhe ta gjejmë qëllimin e përbashkët.

Ne të gjithë e shohim marshin e kthimit të stileve më autoritare të qeverisjes në tërë botën, duke i kufizuar përfundimisht llojet e qeverisjes ku zëri i të gjithëve nuk dëgjohet. Zhvillimet e fundit në botë tregojnë sa delikate janë arritjet për gratë në shumë vende, posaçërisht në shoqëritë në konflikt dhe në shoqëritë pas konfliktit.

Të gjithë jemi të interesuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë me qeveri të përgjegjshme, të cilat u japin përparësi të drejtave të njeriut, përfshirjes dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve dhe më pas i hyjnë punës për të siguruar që të gjithë të kenë qasje në shkollim dhe që njerëzit të kenë qasje në kujdes të mirë shëndetësor.

Besoj që ka pasur reagim të ashpër në botë dhe tani e shohim atë qartazi edhe në Afganistan, por kjo nuk është arsye për ta humbur shpresën ose për t'u ndaluar e thënë, "Unë do të heq dorë" – mos u dorëzoni.



Reyes Charle Cuellar, Këshilltare e PSBE-së për çështje gjinore

Përfshirja domethënëse e grave në negociatat për paqe e ka potencialin për ta rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e proceseve dhe për ta ndihmuar pajtimin.

Gratë në Kosovë kanë treguar se janë të gatshme të kontribuojnë dhe Kosova nuk duhet ta humbasë mundësinë për t'i përfshirë ato.



Vlora Hoti, Drejtoreshë Ekzekutive

United Women's Assotiation

Eksperte kryesore – Gratë në tryezën e negociatave në Kosovë

Pjesëmarrja e grave në tryezën e negociatave është vendimtare për procesin e ndërtimit të paqes dhe zbatimin e qëndrueshëm të marrëveshjeve të mundshme.

Kosova ka një kapacitet të madh, gra që janë udhëheqëse të afta, me ndikim dhe kompetente, që do të ishte kontribut i madh për ndërtimin e paqes në dialog, si dhe në marrëveshjen përfundimtare.

Më shumë gra në pozita vendimmarrëse kanë dëshmuar se kanë ndikim më të madh në të gjitha proceset në përparimin e Kosovës dhe të vendeve të tjera që shërbejnë si shembull.



Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive

New Social Initiative

Eksperte kryesore – Gratë në tryezën e negociatave në Kosovë

Përfshirja e grave në negociata nuk është vlerë e shtuar për dialogun, por kusht i domosdoshëm nëse duam që interesat dhe problemet e të gjithë qytetarëve të trajtohen në proces.

Kemi parë si u zhvilluan dhe si përfunduan proceset e negociatave të mëparshme. Të gjitha kishin një gjë të përbashkët – gratë ishin të nënpërfaqësuar në tryezën e negociatave.

Pakënaqësia gjithnjë e më e madhe e qytetarëve të Kosovës lidhur me dialogun e Brukselit tregon se nevojiten ndryshime, jo vetëm në mënyrën si është udhëhequr, por edhe në mënyrën si po flasim për të. Një nga zgjidhjet mund të jetë që të ketë më shumë gra në tryezë.



Agjenda për gratë, paqen dhe sigurinë - RKS KB 1325

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e miratoi njëzëri Rezolutën 1325 mbi gratë, paqen dhe sigurinë më 31 tetor 2000,¹ një arritje thelbësore për përfshirjen e grave në proceset e paqes anembanë botës.

Kjo ishte hera e parë që Këshilli i Sigurimit e trajtoi ndikimin joproporcional dhe unik të konfliktit të armatosur mbi gratë dhe i njohu kontributet e nënvlerësuara e të papërdorura që bëjnë gratë në parandalimin e konflikteve, ruajtjen e paqes, zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes. Ai gjithashtu e theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë e të plotë të grave si aktore aktive në paqe e siguri.²

Rezoluta 1325 kërkon nga shtetet anëtare që të sigurojnë përfaqësim të shtuar të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet dhe mekanizmat kombëtarë, rajonalë e ndërkombëtarë për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Me këtë dispozitë, Këshilli i Sigurimit bëri presion mbi Qeveritë për ta rritur numrin e grave të përfshira në vendimmarrje në të gjitha nivelet për parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

Pasi e kishte theksuar edhe më parë nevojën për përfshirje më të madhe të grave (d.m.th. baraspeshën gjinore) në vendimmarrje për paqe e siguri, Këshilli i Sigurimit thekson nevojën për t'i përfshirë gratë lokale dhe për t'i vlerësuar proceset autoktone. Po ashtu me rëndësi, ky paragraf sugjeron që përmbajtja e marrëveshjeve duhet t'i pasqyrojë çështjet gjinore, pavarësisht faktit se kush po i negocion apo kush po i zbaton ato.³

Në vitet në vijim, Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka miratuar shumë rezoluta për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS): 1820 (2008), 1888 (2008), 1889 (2009), 1960 (2010), 2106 (2013), 2122 (2013), 2242 (2015), 2467 (2019) dhe 2493 (2019). Bashkë me RKS KB 1325, ato e përbëjnë kornizën e politikave ndërkombëtare mbi agjendën për gratë, paqen dhe sigurinë.

Të gjitha u miratuan si përgjigje ndaj avokimit të vazhdueshëm nga shoqëria civile. Si rezoluta detyruese të Këshillit të Sigurimit, ato duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare dhe aktorët përkatës, përfshirë entitetet e sistemit të OKB -së dhe palët në konflikt.

¹ Rezoluta 1325 (2000): <https://www.un.org/womenwatch/osagi/wp>

² Lidhja Ndërkombëtare e Grave për Paqe dhe Liri: <https://www.peacewomen.org/security-council/WPS-in-SC-Council>

³ Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë, UNIFEM, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1325 Shënuar dhe Shpjeguar, http://www.peacewomen.org/assets/file/BasicWPSDocs/annotated_1325.pdf

Plani i Veprimit i BE-së për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) 2019-2024

BE -ja e ka përforcuar angazhimin e vet për ta promovuar barazinë gjinore, duke njoftuar se e ka ambicien për ta luajtur një "rol prijës si katalizator për barazi gjinore" dhe për të "prirë me shembull" në promovimin global të qëllimeve për GPS-në në vitet e ardhshme.⁴

Kjo ambicie shprehet në Planin e fundit për Veprim të BE-së për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) (2019-24) dhe Planin e Veprimit të BE-së për barazi gjinore (GAP) III.⁵

Plani i Veprimit për gratë, paqen dhe sigurinë paraqet një grup të treguesve, p.sh. për mbështetjen e BE-së për udhëheqjen dhe pjesëmarrjen e grave në mbarë botën ose për suksesin e BE-së në promovimin e "mbrojtjes dhe ruajtjes së të drejtave të grave dhe vajzave" në baza ndërkombëtare.

Qasja strategjike synon ta ripohojë zbatimin e plotë të agjendës për GPS-në dhe e njeh barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si parakusht për t'u marrë me parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konfliktit. Plani i Veprimit i BE-së për GPS-në rikujton angazhimet e Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare të tij për zbatimin e plotë të agjendës për GPS-në (Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1325 dhe rezolutat e tij pasuese). Ai përpaket të sigurojë që është plotësisht i integruar në të gjitha përpjekjet e BE-së që e mbështesin paqen e qëndrueshme, sigurinë, të drejtat e njeriut, drejtësinë dhe zhvillimin në bashkëpunimin e BE-së me organizatat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare, siç parashihet nga Strategjia Globale e BE-së.

Kjo do të bëhet duke i integruar perspektivat gjinore në të gjitha politikat e BE-së, përfshirë sigurinë, parandalimin e konflikteve, zgjidhjen dhe ndërtimin e paqes afatgjate. Në këtë drejtim, BE-ja dhe shtetet anëtare të tij e mbështesin zbatimin e agjendës për GPS-në në OKB.

Plani i Veprimit i identifikon objektivat siç janë definuar në RKSKB 1325, nën fushat kryesore prioritare të parandalimit, mbrojtjes, ndihmës dhe rimëkëmbjes, dhe tri parimet kryesore dhe të rëndësishme të pjesëmarrjes, integritetit gjinor dhe udhëheqjes me shembull.


⁴ <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-11031-2019-INIT/en/pdf>

⁵ http://www.realinstitutoelcano.org/wps/portal/rielcano_en/contenido?WCM_GLOBAL_CONTEXT=/elcano/elcano_in/zonas_in/ari36-2021-almqvist-rekindling-the-agenda-on-women-peace-and-security-can-the-eu-lead-by-example

Gratë në proceset e negociatave

Ndërmjet viteve 1992 dhe 2019, gratë përbënin, mesatarisht, 13 për qind të negociatorëve, 6 për qind të ndërmjetësuesve dhe 6 për qind të nënshkruesve në proceset kryesore për paqe në mbarë botën. Ndërmjet viteve 2015 dhe 2019, 14 për qind e negociatorëve, 11 për qind e ndërmjetësve dhe 7 për qind e nënshkruesve në proceset kryesore për paqe ishin gra. Edhe pse ka pasur përparim në pjesëmarrjen e grave, rreth shtatë nga çdo dhjetë procese paqësore ende nuk përfshinin gra ndërmjetësuese ose nënshkruese – duke treguar se pak gra morën pjesë në role udhëheqëse si negociatore, garantuese ose dëshmitare.⁶

Një analizë e 1,860 marrëveshjeve për paqe në vitet 1990–2019 tregon se vetëm 20% e tyre përmbajnë referenca për gratë, vajzat dhe gjininë, ndërsa vetëm 6 për qind e tyre kishin së paku një dispozitë që e trajtonte në mënyrë të qartë dhunën kundër grave.⁷



Në vitin 2020, 6 nga 21 marrëveshjet për paqe përmbanin referenca për gratë, vajzat dhe gjininë (29 për qind e marrëveshjeve për paqe globale).⁸ Pesë nga gjashtë marrëveshjet për paqe me dispozita gjinore në vitin 2020 ishin marrëveshje të mirëfillta. Ato i trajtojnë pjesërisht ose tërësisht çështjet thelbësore për zgjidhjen e konfliktit dhe ka më shumë gjasa të përmbajnë referenca për gratë sesa marrëveshjet si armëpushimet.⁹

Një studim i analizoi 130 marrëveshje paqësore të nënshkruara që nga viti 1990 dhe gjeti një lidhje të rëndësishme nga pikëpamja statistikore ndërmjet marrëveshjeve për paqe të nënshkruara nga gratë dhe qëndrueshmërisë së paqes. Studimi gjithashtu zbuloi se lidhjet ndërmjet grave nënshkruese dhe grupeve të shoqërisë civile të drejtuara nga gratë çuan në më shumë dispozita në marrëveshjet

⁶ Këshilli për Punë të Jashtme, Pjesëmarrja e grave në proceset e paqes, <https://www.cfr.org/womens-participation-in-peace-processes/>

⁷ Burimi: Baza e të dhënave gjinore e marrëveshjeve për paqe PA-X: <https://www.cfr.org/womens-participation-in-peace-processes/>

⁸ Wise, L. (2021, Qer 18). Marrëveshjet për paqe me perspektivë gjinore janë ende përjashtim, jo rregull. Gratë LSE, Paqja dhe Siguria. <https://blogs.lse.ac.uk/wps/2021/06/18/peace-agreements-with-a-gender-perspective-are-still-an-exception-not-the-rule/>

⁹ Wise, L. (2021, Qer 18). Marrëveshjet për paqe me perspektivë gjinore janë ende përjashtim, jo rregull. Gratë LSE, Paqja dhe Siguria. <https://blogs.lse.ac.uk/wps/2021/06/18/peace-agreements-with-a-gender-perspective-are-still-an-exception-not-the-rule/>

përfundimtare të fokusuara në reformën politike dhe në nivele më të larta të zbatimit, gjë që i rriti gjasat për paqe të qëndrueshme.¹⁰ Hulumtimi që i ekzaminoi të gjitha marrëveshjet për paqe në periudhën pas Luftës së Ftohtë zbuloi se pjesëmarrja e grupeve të shoqërisë civile, përfshirë organizatat e grave, bëri që një marrëveshje për paqe të kishte 64 për qind më pak gjasa për të dështuar.¹¹

Sipas studimit global mbi Rezolutën 1325 të RKSKB-së, pjesëmarrja e grave i rrit për 20 për qind gjasat e një marrëveshjeje për paqe që zgjat së paku dy vjet dhe për 35 për qind gjasat e një marrëveshjeje për paqe që zgjat 15 vjet.¹²

Një vlerësim cilësor i 40 negociatave për paqe dhe hartim të kushtetutave që nga viti 1990 zbuloi se palët kishin më shumë gjasa të pajtoheshin për bisedime dhe më pas ta arrinin një marrëveshje kur grupet e grave ushtronin ndikim të fortë në procesin e negociatave sesa kur ato kishin pak ose nuk kishin fare ndikim.¹³ Ekzaminimi i rasteve studimore zbuloi se një prani e fortë e grave, madje edhe drejtpërdrejt në tryezën e negociatave, nuk përkthehet automatikisht në aftësinë e tyre për ta pohuar një ndikim të fortë.

Niveli i fuqisë që gratë mund ta pohojnë në këtë proces bën një ndryshim, jo vetëm prania e tyre sipas numrave.¹⁴

Lidhur me përfaqësimin e drejtpërdrejtë të grave në tryezën e negociatave, delegacionet e përbëra vetëm nga gratë kishin një ndikim të përgjithshëm më të rëndësishëm në proces sesa gratë individuale brenda delegacioneve të tjera zyrtare të negociatave – edhe kur ato e përbënin një pjesë të madhe të atij delegacioni. Në shumë raste në të cilat gratë përfaqësoheshin në numër të madh në delegacionet negociuese, ato mund ta përdornin efektivisht praninë e tyre relativisht të lartë duke i kapërcyer linjat e delegacioneve të tyre përkatëse dhe duke formuar koalicione për arritjen e interesave të përbashkëta. Kjo kryesisht ndodhi kur grave u bëhej presion bashkërisht brenda dhe/ose jashtë negociatave për ta nënshkruar një marrëveshje.¹⁵

Kur gratë e kishin statusin e vëzhguesit, ato kishin ndikim vetëm kur ishin të lidhura ngushtë me palët në konflikt. Në të njëjtën kohë, një lidhje e tillë e ngushtë shpesh e sfidonte legjitimitetin e tyre.¹⁶

Gratë kanë role dhe përgjegjësi të ndryshme shoqërore ndaj burrave, kështu që ato kanë qasje në rrjete shtesë të informimit dhe të komunitetit. Ato kanë më shumë gjasa t'i ngrenë prioritetet si reformat politike dhe ligjore, rimëkëmbjen ekonomike, drejtësinë tranzicionale – çështjet që i bëjnë marrëveshjet më të qëndrueshme. Këto shpesh lihen mënjanë kur gratë nuk përfshihen, duke rezultuar në një marrëveshje që përqendrohet tërësisht në veprime ushtarake, përfitime territoriale dhe aranzhime të ndarjes së pushtetit, të cilat nuk u ndihmojnë komuniteteve të rimëkëmben dhe të ndërtojnë mbështetje lokale për procesin e paqes.¹⁷ Projekti hulumtues "Zgjerimi i pjesëmarrjes në negociata dhe zbatim politik" nuk gjeti raste kur grupet e grave organizonin aksion masiv kundër një marrëveshjeje për paqe. Përkundrazi, gratë janë përfshirë dhe kanë kryer fushata masive në dobi të marrëveshjeve për paqe më shumë se çdo grup tjetër. Gratë shpesh u kanë bërë presion palëve në konflikt për t'i filluar negociatat dhe për të nënshkruar marrëveshje për paqe.¹⁸

¹⁰ Krause, J., Krause, W., & Bränfors, P. (2018). Pjesëmarrja e grave në negociatat për paqe dhe qëndrueshmëria e paqes. Ndërveprimet ndër-kombëtare, 44(6), 985-1016. <https://pure.uva.nl/ws/files/26826416/Krause.pdf>

¹¹ <https://www.cfr.org/womens-participation-in-peace-processes/why-it-matters>

¹² Studimi global mbi Rezolutën 1325 të KSKB-së, <https://wps.unwomen.org/participation/>

¹³ <https://www.cfr.org/womens-participation-in-peace-processes/why-it-matters>

¹⁴ Gratë duhet të përfshihen – Jo vetëm të numërohen: Vlerësimi i Përfshirjes dhe ndikimit të grave në negociatat për paqe, Iniciativa gjithëpërfshirëse për paqe dhe tranzicion, faqe 55 https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/IPTI-UN-Women-Report-Making-Women-Count-60-Pages_0.pdf

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Pjesëmarrja e grave në proceset e paqes, Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë, <https://www.cfr.org/womens-participation-in-peace-processes/why-it-matters>

¹⁸ Gratë duhet të përfshihen – Jo vetëm të numërohen: Vlerësimi i përfshirjes dhe ndikimit të grave në negociatat për paqe, Iniciativa gjithëpërfshirëse për paqe dhe tranzicion, faqe 35, https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/IPTI-UN-Women-Report-Making-Women-Count-60-Pages_0.pdf

Korniza ligjore e Kosovës për përfshirjen e grave në vendimmarrje dhe negociata

Kushtetuta e Kosovës e njeh barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave dhe të burrave në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore.¹⁹

Kosova nuk është nënshkruese e marrëveshjeve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, Kushtetuta i përkufizon konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, si të zbatueshme drejtpërdrejt në legjislacionin e vendit.²⁰

Kushtetuta gjithashtu pohon se përbërja e Kuvendit të Kosovës do t'i respektojë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.²¹

Ligji Nr. 05/L-020 për barazinë gjinore²² i përcakton masat e përgjithshme dhe specifike për t'i siguruar dhe mbrojtur të drejtat e barabarta të burrave dhe grave dhe i përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Organet legjislative, ekzekutive e gjyqësore në të gjitha nivelet dhe institucionet e tjera publike janë të detyruara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për ta rritur përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar derisa të arrihet përfaqësimi i barabartë i grave dhe burrave sipas këtij ligji.

Masat e posaçme mund të përfshijnë:

- kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave;
- mbështetjen e programeve për ta rritur pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike;
- fuqizimin ekonomik dhe hapat për ta përmirësuar pozitën e grave ose burrave në fushën e punës, përmirësimin e barazisë në arsim, shëndetësi, kulturë dhe shpërndarjen dhe/ose rishpërndarjen e burimeve;
- trajtimin preferencial, rekrutimin, punësimin dhe promovimin, dhe masa të tjera në secilën fushë ku ka paparazi.

Siç përcaktohet me këtë ligj, përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur të sigurohet një përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.

Ligji 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme²³ në vitin 2008 paraqiti kriteret për kuota gjinore në procesin e zgjedhjeve. Të gjitha subjektet politike dhe organet zgjedhore janë të detyruara t'i respektojnë kriteret e përcaktuara me këtë ligj për kuotën gjinore. Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik, të paktën tridhjetë (30%) për qind duhet të jenë burra dhe të paktën tridhjetë (30%) për qind duhet të jenë gra, me një kandidat nga secila gjini të përfshirë të paktën një herë në secilin grup prej tre kandidatëve, duke numëruar nga kandidati i parë në listë.²⁴

¹⁹ Kushtetuta e Kosovës, neni 7, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

²⁰ Kushtetuta e Kosovës, neni 22, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

²¹ Kushtetuta e Kosovës, neni 71,2 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

²² Ligji Nr. 05/L-020 për barazinë gjinore, nenet 1,2,5,6 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

²³ Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

²⁴ Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme, neni 27.1 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

Sipas Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, subjektet politike duhet të sigurojnë që kuota gjinore zbatohet në listën e partive të tyre; në të kundërtën, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk do ta certifikojë listën e tyre, duke i penguar kështu për të marrë pjesë në zgjedhje.

Zbatimi i kuotës gjinore është gjithashtu i detyrueshëm për KQZ-në me rastin e ndarjes së ulëseve në Kuvend ndërmjet partive politike. Nëse, pas ndarjes së ulëseve, kandidatëve të gjinisë pakicë brenda një subjekti politik nuk u janë ndarë të paktën 30% të ulëseve të përgjithshme për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë do të zëvendësohet nga kandidati tjetër i gjinisë së kundërt derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë të paktën 30%.

Ekziston një mospërputhje ligjore ndërmjet Ligjit për barazinë gjinore dhe Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme për kuotat gjinore. Edhe pse Ligji për barazinë gjinore kërkon 50 për qind përfaqësim të grave në përgjithësi, Ligji për zgjedhjet e përgjithshme kërkon që vetëm 30 për qind e të gjithë kandidatëve të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Ndërsa ligji i parë e përcakton kuotën gjinore si diçka që duhet të synohet, ligji i dytë e bën kuotën gjinore të detyrueshme, që është arsyeja kryesore që ajo respektohet.

Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës (PKV) për zbatimin e RKS KB 1325 dhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024

Plani i parë Kombëtar i Veprimit i Kosovës (PKV) për zbatimin e RKS KB 1325 u miratua në janar 2014. Duke pasur një qasje për të drejtat e njeriut, dokumenti u zhvillua nga institucionet qendrore bashkë me anëtarët e shoqërisë civile dhe u mbështet nga OKB-ja.

Ai synonte forcimin e tri fushave kryesore për gratë, paqen dhe sigurinë: ta rrisë dhe sigurojë pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse dhe ndërtimin e paqes; ta fusë integrimin gjinor në sektorin e sigurisë; dhe të sigurojë qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës. Vetëm i fundit është duke u zbatuar me themelimin e Komisionit për Verifikimin e Statusit të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Luftës në vitin 2018.

Grupi për Siguri dhe Çështje Gjinore (GSÇGj) është funksional që nga viti 2007. I kryesuar nga UN Women, ky forum me shumë aktorë synon ta rrisë bashkëpunimin për çështje gjinore ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë, edhe nga institucionet publike edhe nga shoqëria civile. Gjatë viteve, GSÇGj-ja ka bërë disa deklaratat publike duke bërë thirrje për përfshirjen e grave në negociatat ndërkombëtare, përfshirë dialogun.

Në maj 2020, Qeveria e Kosovës (QK) e miratoi Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024²⁵ dhe Planin e saj të Veprimit 2020-2022, duke i detyruar kështu institucionet që ta zbatojnë atë sipas aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit. Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit dhe raportimin vjetor për të.

Siç thuhet në Program, qëllimi i përgjithshëm strategjik është “të sigurohet që barazia gjinore vendoset në qendër të proceseve të transformimit në Kosovë, në të gjitha strukturat, institucionet, politikat, procedurat, praktikat dhe programet e qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.”²⁶ Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në negociatat përcaktohet gjithashtu nga ky Program si një nga qëllimet.

²⁵ Qeveria e Kosovës: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/the-government-approves-kosovo-program-for-gender-equality-and-the-decision-to-initiate-procedures-for-declaring-the-former-prison-in-prishtina-a-museum/>

²⁶ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, faqe 10 <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>

Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në procesin e vendimmarrjes në përputhje me kërkesat e Ligjit për barazinë gjinore²⁷

Për të garantuar pjesëmarrje të barabartë gjinore në proceset e vendimmarrjes, Programi thekson nevojën për harmonizimin dhe plotësimin e ligjeve (veçanërisht të Ligjit për zgjedhjet, Ligjit për financimin e partive politike dhe Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës) në përputhje me Ligjin mbi barazinë gjinore.

Partitë politike dhe Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës duhet ta respektojnë Ligjin për barazinë gjinore.

Institucionet publike duhet të zbatojnë masa afirmative për ta përmbushur kuotën gjinore të përcaktuar me Ligjin për barazinë gjinore për gratë për t'i përfaqësuar 50% të punonjësve në të gjitha nivelet.

Për t'i promovuar gratë që tashmë janë pjesë e institucioneve publike në pozitë vendimmarrëse në nivelin lokal e qendror, institucionet duhet ta mbështesin përparimin e tyre profesional duke ofruar bursa dhe sesione trajnimi të nevojshme për pozita udhëheqëse.

Ekziston nevoja edhe për organizimin e fushatave vetëdijesuese mbi transparencën dhe ndarjen e barabartë të fondeve për gratë dhe burrat në parti politike.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit²⁸

Ky objektivi synon të avokojë për përfshirjen e grave në proceset e paqes, negocimit dhe pajtimit, përfshirë mekanizmat ose komisionet qeveritare që merren me të kaluarën, përfshirë pjesëmarrjen e grave nga etnitë e ndryshme.

Ky Program e përcakton nevojën për ta adresuar riparimin e dëmeve për të mbijetuarit e dhunës seksuale, të krimeve të luftës dhe të dhunës seksuale kundër grave në vitet 1998–1999 për t'u përfshirë në dialogun aktual aktiv ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Aktivitetet që do të çojnë drejt përmbushjes së këtij objektivi janë lobimi dhe avokimi për përfshirjen e grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit, dhe organizimi i debateve publike mbi përfaqësimin e grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit.

Plani i Veprimit për Barazi Gjinore nuk ka të dhëna nga vitet e kaluara mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në institucionet publike. Megjithatë, ai e përcakton objektivin prej 30% në vitin 2021–2022 dhe 40% në vitin 2024. Në vitin 2017/2018, gratë mbanin 27% të pozitave menaxhuese dhe të pozitave të larta menaxhuese në ministri dhe agjenci ekzekutive në nivelin qendror. Qëllimi për t'u arritur në vitin 2021/2022 është 28% dhe 30% në vitin 2024.²⁹

Në të njëjtat pozita në nivel komunal, në vitin 2017/2018, kishte 20% gra. Deri në vitin 2021/2022, duhet të ketë 25% gra dhe 30% në vitin 2024. Deri në vitin 2024 duhet të ketë 50% gra në Kuvendin e Kosovës dhe në kuvende komunale.

Sa i përket nivelit të përfaqësimit të grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit, Plani i Veprimit

²⁷ Po aty, faqe 65

²⁸ Po aty, faqe 66

²⁹ Po aty, faqe 66

thekson se në vitin 2018 ato nuk ishin të përfaqësuara fare. Qëllimi për vitin 2021/2022 është 20%, dhe deri në vitin 2024, 30% e grave duhet të jenë në këto procese.³⁰

Planin e Veprimit, 2020–2022 i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024, ka një kosto buxhetore prej 13,726,638 eurove. Kostoja buxhetore prej 2,596,350 eurove do të financohet nga buxheti i Kosovës, ndërsa shuma prej 11,140,288 eurove do të mbulohet nga donatorët. Donatorët kryesorë që pritët ta mbështesin Planin e Veprimit të PKBGj-së për vitin 2020–2022 janë: Komisioni Evropian, SIDA, Agjencitë e OKB-së në Kosovë dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.³¹



(Foto Ilustrim: AFP – Women in Kosovo)

³⁰ Po aty, faqe 132

³¹ Po aty, faqe 72

Gratë në pozita vendimmarrëse në Kosovë

Në vitin 2021 Kosova zgjodhi Presidenten e dytë, znj. Vjosa Osmani. 44 deputetë në Kuvendin e Kosovës (nga 120) dhe pesë ministra në Qeverinë e Kosovës (nga 15) janë gra, më shumë se në çdo organ të mëparshëm qeverisës dhe legjislativ.

Kuvendi i Kosovës i ka 14 komisione parlamentare. Gratë i kryesojnë tetë prej tyre.³²

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione³³ është i vetmi komision me gra si anëtarë të shumicës dërrmuese (9 nga 11), dhe kryetare është një grua. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes janë dy komisionet e vetme me një grua (1 nga 11 anëtarë). Megjithatë, kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë është grua.

Agjencia e Statistikave të Kosovës çdo vit³⁴ publikon statistika gjinore në botimin "Gratë dhe Burrat në Kosovë". Mirëpo, statistikat më të fundit në dispozicion janë nga viti 2018/2019.³⁵

Në vitin 2018, 10 gra dhe 75 burra ishin në pozita menaxhuese të nivelit të lartë, ndërsa 390 gra dhe 1023 burra ishin në pozita të nivelit drejtues në ministrinë e Qeverisë së Kosovës.³⁶

Table 2. Employees in decision-making positions by the Ministry, 2018

Ministries	Senior management level				Leading level			
	Gender		Gender distribution		Gender		Gender distribution	
	Women	Men	Women	Men	Women	Men	Women	Men
Office of the Prime Minister	1	8	11	89	39	85	31	69
of the Security Forces		1	0	100	9	27	25	75
of Trade & Industry	2	7	22	78	13	33	28	72
of Health	1	3	25	75	10	13	43	57
of Culture, Youth, Sports & Resident Affairs		2	0	100	21	40	34	66
of Infrastructure		1	0	100	5	32	14	86
of Labor & Social Welfare		4	0	100	19	64	23	77
of Public Administration	1	2	33	67	14	25	36	64
of Education, Science & Technology	3	12	20	80	22	57	28	72
of Economics & Finance		4	0	100	53	175	23	77
of Agriculture, Forestry & Rural Development		4	0	100	19	48	28	72
of Economic Development		2	0	100	8	25	24	76
of Local Government Administration	1		100	0	12	11	52	48
of Environment & Spatial Planning		3	0	100	11	34	24	76
of Justice		8	0	100	31	81	28	72
of Internal Affairs		6	0	100	63	200	24	76
of Foreign Affairs		3	0	100	4	16	20	80
for Communities & Returns		1	0	100	4	11	27	73
for European Integration		1	0	100	8	15	35	65
for Diaspora	1		100	0	4	14	22	78
The Assembly of Kosovo								
Presidency		1	0	100	17	14	55	45
Regional MZH		1	0	100	3	3	50	50
Innovation & Entrepreneurship		1	0	100	1		100	0

Data source: MPA, November 2020

³² Ueb sajti i Kuvendit të Kosovës, <https://www.kuvendikosoves.org/eng/comittees/>

³³ Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, Ueb sajti i Kuvendit të Kosovës, <https://www.kuvendikosoves.org/eng/comittees/committee/?committee=56>

³⁴ Gratë dhe Burrat në Kosovë, 2014–2015, [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/ASK%20Women%20and%20Man%202014%202015\(1\).pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/ASK%20Women%20and%20Man%202014%202015(1).pdf)

Gratë dhe Burrat në Kosovë, 2016–2017, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/women-and-men-in-kosovo-2016-2017>

³⁵ Gratë dhe Burrat në Kosovë, 2018–2019, <https://ask.rks-gov.net/media/6118/women-and-man-2018-2019.pdf>

³⁶ Gratë dhe Burrat në Kosovë, 2018–2019, faqe 62, <https://ask.rks-gov.net/media/6118/women-and-man-2018-2019.pdf>

Në vitin 2018, në misionet diplomatike të Kosovës, 46 (29%) e anëtarëve të stafit ishin gra (112 (71%) ishin burra). Përfaqësimi i grave në misionet diplomatike shënoi rënie në vitin 2019; 50 punonjës ishin gra (27.8%), ndërsa 130 (72.2%) ishin burra.³⁷

Në 38 komunat e Kosovës, të gjithë kryetarët e komunave janë burra. Kosova vetëm një herë kishte një kryetare të komunës – Mimoza Kusari Lila, e cila e mbajti këtë pozitë në Gjakovë prej vitit 2014–2017. Por, kjo situatë ka të ngjarë të ndryshojë pasi në zgjedhjet e ardhshme komunale do të jenë 13 gra candidate për kryetare të komunave.³⁸

Burrat ua kalojnë grave në numër në të gjitha institucionet komunale. Shumica e asamblistëve në kuvendet komunale janë gjithashtu burra (347 – gra, 637 – burra). Katër mijë e pesëqind e shtatë burra (4507) mbajnë pozita administrative në krahasim me 1871 gra, ndërsa 303 burra dhe 101 gra janë në pozita vendimmarrëse në strukturat lokale komunale. Në Dragash, Mamushë dhe Shtërpce, asnjë grua nuk mban pozitë udhëheqëse. Nga 38 kryesues të kuvendeve komunale, vetëm 6 prej tyre janë gra.³⁹

³⁷ Po aty, faqe 64

³⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lista e kandidatëve të certifikuar për kryetarë komune për zgjedhjet lokale të vitit 2021: https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/09/2021-09-09-Lista-Totale-Kryetar-Komune-Tetor-2021_final_7.pdf

³⁹ Gratë në Politikë III, Përfaqësimi gjinor në nivelin lokal, Balkans Policy Research Group, mars 2021, <https://balkansgroup.org/en/women-in-politics-iii-gender-representation-at-local-level/>

Gratë në tryezën e negociatave në Kosovë

Në dy dekadat e fundit, Kosova është ulur tri herë në tryezën e negociatave me Serbinë – në Rambuje në vitin 1999, pastaj në Vjenë në vitin 2006–2007, dhe që nga viti 2011 në Bruksel. Dy proceset e para të negocimit nuk ishin të suksesshme – nuk u arrit asnjë marrëveshje për paqe, ndërsa pritjet e publikut për dialogun e Brukselit, të udhëhequr nga BE-ja, po zbehen me kalimin e viteve.

Sondazhi publik i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë sugjeron që qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë i ndajnë kryesisht perceptimet e tyre negative për procesin e dialogut në Bruksel. Ata besojnë që dialogut i mungonte transparenca dhe nuk ndryshoi asgjë, ose që ata nuk kishin përfitime personale nga procesi.⁴⁰

E përbashkëta e të gjitha këtyre proceseve të negocimit është se gratë nuk ishin të përfaqësuara në mënyrë të konsiderueshme në tryezë. Në konferencën për paqe në Rambuje, shqiptarët e Kosovës u përfaqësuan nga 16 burra dhe një grua. Gjatë bisedimeve në Vjenë, "Ekipi i Unitetit", i përbërë vetëm nga burrat, po negocionte në emër të burrave dhe grave të Kosovës. Një grua ishte kryesuese e delegacionit të Kosovës në negociatat e Brukselit prej vitit 2011 deri në vitin 2017. Që nga ajo kohë, vetëm edhe një grua tjetër ishte zyrtarisht pjesë e delegacionit të Kosovës në dialogun teknik në gjysmën e parë të vitit 2018.

Gjatë kësaj kohe, në Kosovë ka pasur nisma lokale që synonin ta trajtonin rolin e grave në paqe dhe siguri. 88 nisma të tilla u identifikuan prej vitit 1999–2012 në një ushtrim hartëzimi [mapping exercise] të realizuar nga UN Women, UNDP-ja dhe BE-ja. Pjesa më e madhe e tyre janë financuar nga organizatat ndërkombëtare që i kanë mbështetur institucionet vendore për ta adresuar pabarazinë gjinore dhe mungesën e pjesëmarrjes së grave në politikë, siguri dhe politika ekonomike.⁴¹

Prej 88 nismave prej vitit 1999 deri në vitin 2012, vetëm tri u përqendruan në gratë në tryezën e negociatave: **Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC)** e organizoi një diskutim publik mbi çështjen e pjesëmarrjes së grave në negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës, organizoi diskutime publike me Lobin e Grave të Kosovës për ta mbrojtur përfshirjen e grave në negociatat për paqe në vitin 2006.

Gjithashtu, në vitin 2006, **Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)** e organizoi një protestë për t'i përfshirë gratë në ekipin negociues, duke u bazuar në thirrjet e RKSKB 1325 në vitin 2006; – Në vitin 2007, RrGK-ja nënshkroi një memorandum që shënoi fillimin e monitorimit të përbashkët të negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të siguruar që zërat e grave të merren parasysh (financuar nga UN Women).

Edhe në vitin 2012 kishte një nismë nga **Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi (RWL)**, i cili e organizoi dialogun ndërmjet deputeteve nga Serbia dhe Kosova (i financuar nga Ambasada e Finlandës). Që nga ajo kohë, RWL-ja ka vazhduar të punojë dhe të takohet rregullisht dhe ta ngritë vetëdijësimin mbi nevojën e përfshirjes së grave nga Kosova dhe Serbia në dialog.

⁴⁰ Perceptimi mbi Dialogun Kosovë – Serbi dhe çështjet e identitetit, Perspektiva e qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, Janar 2021, faqe 5, [http://www.qkss.org/repository/docs/Dialogue_ENG_\(1\)_704168.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Dialogue_ENG_(1)_704168.pdf)

⁴¹ Hartëzimi i nismave lokale për gratë, paqen dhe sigurinë në Kosovë 1999–2012, UNDP, https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/womens_empowerment/mapping-of-local-initiatives-on-women--peace-and-security-in-kos.html

Konferenca e Rambujesë për Kosovën

Konferenca e Rambujesë për Kosovën⁴² shënoi fundin e përpjekjeve për zgjidhjen paqësore të krizës së Kosovës. Bisedimet për paqe filluan më 6 shkurt 1999, në kështjellën franceze të Rambujesë, afër Parisit.



(Foto ilustrim: REUTERS)

Në konferencë morën pjesë përfaqësues të autoriteteve të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të shqiptarëve të Kosovës, me ndërmjetësimin e të dërguarve të SHBA-së, Rusisë dhe BE-së. Pas 17 ditëve të negociatave, bisedimet përfunduan më 23 shkurt 1999, pa rezultate.

Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës përbëhej nga 17 anëtarë – Azem Syla, Bajram Kosumi, Blerim Shala, Bujar Bukoshi, Fehmi Agani, Hashim Thaçi, Hydajet Hyseni, Ibrahim Rugova, Idriz Ajeti, Jakup Krasniqi, Mark Krasniqi, Mehmet Hajrizi, Ramë Buja, Rexhep Qosja, Veton Surroi, Xhavit Haliti, dhe vetëm një grua – Edita Tahiri.⁴³

Në dëshminë e saj për projektin e historisë gojore të Kosovës, Tahiri shpjegoi se si u formua delegacioni i Kosovës. “Në Marrëveshjen e Rambujesë në të cilën morëm pjesë, unë isha gruaja e vetme në delegacionin e Republikës së Kosovës, por propozimi për të qenë atje nuk erdhi nga brenda sepse nuk kishim asnjë propozim. Emrat për pjesëmarrje në Konferencën e Rambujesë erdhën nga Shtetet e Bashkuara. Në këtë mënyrë u zgjodhën aktorët e lëvizjes paqësore dhe të lëvizjes së armatosur. Por fakti ishte që unë isha e vetmja grua, plus isha Ministre e Punëve të Jashtme me përvojë dhjetëvjeçare në marrëdhëniet ndërkombëtare”, shpjegoi Tahiri.⁴⁴

⁴² Më shumë për Konferencën e Rambujesë për Kosovën, lexoni në: <https://library.fes.de/libalt/journals/swetsfulltext/5385086.pdf>

⁴³ Kush janë anëtarët e delegacioneve, javorja Vreme, nr. 434, 13 shkurt 1999 https://www.vreme.com/arhiva_html/434/3.html

⁴⁴ Historia gojore e Kosovës, Edita Tahiri, <https://oralhistorykosovo.org/edita-tahiri/>

NATO-ja e filloi bombardimin e Republikës Federale të Jugosllavisë më 24 mars, që pas 78 ditësh rezultoi në tërheqjen e forcave serbe nga Kosova. Marrëveshja ushtarako-teknike ndërmjet Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë u nënshkrua më 9 qershor 1999, në aeroportin ushtarak afër Kumanovës. Marrëveshja i ndaloi sulmet ajrore të NATO-s mbi RFJ-në dhe, një ditë më vonë, në Këshillin e Sigurimit u miratua Rezoluta 1244.⁴⁵

Kjo Rezolutë ofron një kornizë për zgjidhjen e konfliktit në Kosovë duke autorizuar vendosjen e një pranie civile dhe ushtarake ndërkombëtare, dhe krijimin e një administrate kalimtare ndërkombëtare dhe të një pranie të sigurisë që do ta mbikëqyrnin kthimin e refugjatëve dhe tërheqjen e forcave ushtarake nga Kosova. Rezoluta gjithashtu thekson se prania civile ndërkombëtare do ta lehtësojë një proces politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës.⁴⁶

Gjithsej 13,548 persona u vranë ose u zhdukën gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Vrasjet, vdekjet e lidhura me luftën, ose zhdukjet janë dokumentuar në Librin e Kujtimit të Kosovës – prej të cilëve 10,333 ishin civilë (1.1.1998 – 31.12.2000). Ndër këto viktime civile, 8,692 ishin shqiptarë, 1,196 serbë, 151 romë, 86 boshnjakë, 77 ashkalinj, 55 malazezë, 37 egjiptianë, 11 goranë egjiptianë, 9 turq dhe 19 anëtarë të grupeve të tjera etnike. Shumica e civilëve dhe luftëtarëve u vranë ose u zhdukën në vitin 1999 (11,225 persona).

